

LAHUTA E MALËSISË

Kënga e Shtatë

KUVENDI I BERLINIT

(PËRSHTATUR NË GJUHË STANDARTE)

ARGUMENTI

*Para ushtimës dhe gjëmës që vjen nga Rumelia,
poeti pyet Zanën e vet për t'i treguar se çfarë janë.
Përgjigjja është e qartë: lufta ndërmjet Turqisë dhe
Rusisë kishte shpërthyer dhe do të kishte vazhduar gjatë,
po të mos kishin ndërhyrë fuqitë e mëdha evropiane.
Kështu fillon Kuvendi i Berlinit. Fatkeqësisht për
Shqipërinë, askush nuk mendon për të në atë mbledhje.
Përkundrazi, Knjaz Nikolla, ndonëse i veshur si lypës,
paraqitet dhe pranohet në kuvend. Ankesat e tij të
përvajshme prekin dhe zbusin zemrat e të mëdhenjve.*

Këta, në marrëveshje me Sulltanin, i japin dorë të lirë mbi viset shqiptare të Veriut dhe vendosin që Plava, Gucia, Shkodra dhe Malësia t'i kalojnë Malit të Zi, kufiri i të cilit do të shtrihej deri në rrjedhën e Drinit. Ky vendim i padrejtë e bën poetin të mallkojë nënshkruesit e aktit mizor dhe të betohet se Shqipëria nuk do t'i lëshohet askujt, pa u derdhur gjaku deri në gju dhe pa u përfshirë bota nga flakët.

Gëzimi i Knjazit është i pamasë. Ai tani mendon vetëm për një të ardhme plot pasuri e të mira, plot madhështi dhe nderime. Kthehet në Cetinë dhe thërret Pal Milanin, të cilit i urdhëron të përgatisë sa më parë pesë batalione dhe me to të niset drejt tokave shqiptare. I jep edhe planin e luftës. Pali, më i urtë se trim, mendon dhe bindet për fjalët e Knjazit, për të cilin ishte gati të hidhej në zjarr e në ujë, por jo të shkonte në Shqipëri. Knjazi qesh me dobësinë e prijësit dhe fillon ta tallë, duke e këshilluar me ironi të bëhej prift ose të merrej me punët e grave në shtëpi. “Ata që nuk i dëgjon Pali, do t'i zbatojë Mark Milani” — thotë krajli — dhe menjëherë jep urdhër të thirret gjithë burrëria në ushtri.

Duke marrë për vete fjalët e Zanës, poeti i drejtohet Knjaz Nikollës dhe e qorton për gabimin që po bën, sepse rëndë ndëshkohet kushdo që sulmon padrejtësisht shqiptarët.